



Prishtinë: 26.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V_320_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_491_11_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14.6 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_491_11_10**;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 26 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Hakip Krasniqi (parashtruesi i ankesës Zenel Kryeziu, shifra e konsumatorit DPR – 90010197), Ëmbëltore “RINIA” nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 13.02.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 30.01.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 15.11.2008 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për ndërrim njehsori.
Provë: Aplikacioni për ndërrim njehsori i datës 20.11.2008
- Me datë 20.11.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë ndërruar njehsorin elektrik, ku kanë hequr njehsorin elektrik nr. 51930 dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 91058889.
Provë: Vërtetimi mbi heqjen dhe ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 009044 të datës 20.11.2008
- Me datë 18.11.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë konstatuar se konsumatori me vet dëshirë e ka këputur vulën distribuive e ka hapur kapakun distributiv dhe e ka larguar urën e dytë të tensionit me çka energjia elektrike që shpenzohet në këtë fazë nuk matet.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 234426 të datës 18.11.2008

- Me datë 26.11.2008 KEK-u e ngarkon konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP07089 në vlerë prej 2,491.18 €. **Provë:** Fatura e KEK-ut DPR08HP07089 e datës 26.11.2008
- Me datë 05.01.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 30.01.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kontrollës. **Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 30.01.2009
- Me datë 13.02.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 08.12.2009 DMK në pajtim me paragrafin 14.3 të nenit 14 të Rregullit mbi Procedurën për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ka analizuar ankesat e konsumatorëve dhe ka vlerësuar se zyrtarët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse gjatë përpilimit të procesverbaleve nuk kanë shënuar shumat e fuqive të shpenzuesve të inventarizuara me rastin e inspektimit të pikave matëse tek konsumatorët komercial dhe industrial ka kthyer në rishqyrtim lëndën e konsumatorit. Sipas kësaj KEK-u ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar. **Provë:** Dokumenti i DMK për rishqyrtimin e ankesave të konsumatorëve
- Me datë 21.05.2010 Komisioni i KEK-ut në përbërje të stafit përgjegjës të operatorit të rrejtit dhe furnizuesit publik, ka refuzuar prapë ankesën e konsumatorit. **Provë:** Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Pasi që DMK e ka dërguar lëndën e konsumatorit në rishqyrtim në KEK, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me datë 14.12.2009 kanë bërë regjistrimin e pajisjeve elektrike. **Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 057154 të datës 14.12.2009
- ✓ KEK-u pasi ka marrë pajisjet elektrike të regjistruara në procesverbalin nr. 057154 të datës 14.12.2009, ka bërë edhe llogaritjen e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Sipas llogaritjeve të bëra nga KEK-u del se konsumatori është dashur të faturohet me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë prej 737.55 €. **Provë:** Llogaritja e KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar
- ✓ Komisioni i KEK-ut pasi ka marrë lëndën e konsumatorit në rishqyrtim, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *“Konsumatori siç shihet nga raporti njehsori – pllomba ka këputur pllombën në periodën 12/2006. Ekipi i kontrollës me dt. 18.11.2008 kanë plotësuar procesverbalin nr. 234426 sipas të cilit: Pala me*

vetdëshirë ka këputur pllombën dhe ka larguar urën e dytë me çka energjia elektrike në këtë fazë nuk matet. Sipas këtij procesverbal, shërbimii faturimit ka përpiluar faturën interne në bazë të seksionit të kabllit. Nga kjo ka rezultuar fatura e RH në vlerë 2491.18 €. Vërejtje: Fatura interne në bazë të cilit llogaritet fatura e RH, sipas Proc. Perk. Per idenë. Dhe paranë. Duhet të bazohet në pajisjet të cilat i furnizon pika matëse e jo në seksionin e kabllit siç është llogaritur RH. Rillogaritja e RH për 24 muaj, me pajisje sipas procesverbalit të kontrollës rezulton në vlerë 737.5€. Vendimi i komisionit: Qëndrojmë pas vendimit të datës 26.11.2008 fatura e DPR08HP07089”.

Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 26.01.2010

- ✓ Komisioni i KEK-ut në vendimin e tyre pas rishqyrtimit të lëndës së konsumatorit ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *Siç shihet nga raporti njehsori – pllomba, konsumatori ka këputur pllombën në periodën 12/2006. Ekipi i kontrollës me dt. 18.11.2008 kanë vizituar pikën matëse dhe kanë plotësuar procesverbalin nr. 234426 ku ceket se konsumatori vet dëshirë ka këputur pllombën dhe ka larguar urën e dytë me çka energjia elektrike në këtë fazë nuk matet. Prandaj, në bazë të fakteve dhe sipas parametrave të paraqitura në procesverbalin nr. 234426 dt. 18.11.2008 konstatojmë se fatura nr. DPR08HP07089 dt. 26.11.2008 në vlerë 2491.18 € është llogaritur konform nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Rillogaritja e RH sipas pajisjeve nga procesverbal nr. 057154 dt. 14.12.2009 rezulton në vlerë 737.55 €. Por pasi evidentimi i këtyre pajisjeve është bërë në një periudhë tjetër nga periudha e rikthimit të humbjeve, komisioni qëndron pas vendimit ekzistues.*
- ✓ KEK-u edhe përkundër asaj që DMK ka kthyer në rishqyrtim ankesën e konsumatorit dhe i ka konstatuar se KEK nuk ka vepruar sipas nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, KEK-u prapë ka refuzuar ankesën e konsumatorit, duke mos e marrë për bazë shkeljen e procedurës.
- ✓ Në deklaratën e konsumatorit theksohet se gjatë një kontrole të KEK-ut kanë hasur në njehsori elektrik që nuk ka vulë (bllomb) dhe se për këtë kanë arritur në përfundim që është keqpërdorur njehsori elektrik. Punëtorët e KEK-ut kanë qenë disa herë në kontroll dhe se nuk kanë gjetur asnjë parregullsi dhe kemi kërkuar nga ata që të vendosin bllombën në njehsorin elektrik, ndërsa ata kanë kërkuar që njehsori elektrik të ndërrohet komplet, për arsye se një pjesë e njehsorit është djegur.
Provë: Deklarata e konsumatorit
- ✓ Konsumatori ka parashtruar vet kërkesë në KEK për ndërrim njehsori, duke kërkuar në KEK që të bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik.
Provë: Aplikacioni për ndërrim njehsori
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike sipas sezonës verore me njehsor të vjetër nr. 51930 për periudhën 04/2008 – 09/2008 ka qenë 253 kWh/muaj, për periudhën 04/2007 – 09/2007 ka qenë 955 kWh/muaj, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit të ri elektrik nr. 91058889 prej periudhës 04/2009 – 09/2009 ka qenë 873 kWh/muaj.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive

- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike sipas sezonës dimërore me njehsor të vjetër nr. 51930 për periudhën 10/2007 – 03/2008 ka qenë 272 kWh/muaj, për periudhën 10/2006 – 03/2007 ka qenë 601 kWh/muaj, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit të ri elektrik nr. 91058889 prej periudhës 10/2009 – 03/2010 ka qenë 515 kWh/muaj.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike sipas viteve është: 2004 – **733.33** kWh/muaj; 2005 – **779.17** kWh/muaj; 2006 – **755.00** kWh/muaj; 2007 – **725.83** kWh/muaj; 2008 – **221.62** kWh/muaj; 2009 – **746.60** kWh/muaj; 2010 (periudha 01/2010 – 09/2010) – **738.33** kWh/muaj. Sipas kësaj analize shihet se mesatarja e shpenzimeve të energjisë elektrike gjatë periudhës 08/2002 e deri 12/2007 ka qenë **767.54** kWh/muaj, gjatë vitit 2008 mesatarja e shpenzimeve të energjisë elektrike ka qenë **215.27** kWh/muaj, ndërsa pas ndërrimit të njehsorit elektrik prapë mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike është **719.29** kWh/muaj. Sipas këtyre analizave shihet qartë se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike vetëm në vitin 2008 ka pësuar rënie të shpenzimit.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Sipas listave të leximit të KEK-ut (librit të leximeve), lexuesi i KEK-ut që nga periudha 10/2006 e tutje e ka evidentuar se njehsori elektrik i konsumatori është në rregull, por që mungon vula distributive dhe këtë e ka evidentuar në listat e leximit të KEK-ut.
Provë: Listat e leximit të KEK-ut
- ✓ Sipas kapitullit të 2 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë, shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike merret i cili nuk regjistrohet në një apo më shumë sisteme të matjes për arsye të largimit të urave, si dhe njehsori elektrik i konsumatorit nuk ka vulat (bllombat)
- ✓ Duke u bazuar në analizat e cekura më lartë KEK-u duhet të llogaris konsumatorit vetëm pjesën për të cilën faza T ka qenë e larguar, pra për periudhën 12/2006 e deri 11/2008.

DMK, duke u bazuar në analizat e cekura më lartë dhe dëshmitë e paraqitura, si dhe duke u bazuar në kapitullin e 2 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë, ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së që të **refuzon pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe të vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP07089 në vlerë prej 2,491.18 €, e datës 26.11.2008.
2. KEK-u duhet të llogarisë vetëm 33 % të energjisë elektrike prej periudhës 12/2006 e deri 11/2008 kur edhe është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik, pra faturave të energjisë elektrike (periudha 12/2006 – 11/2008) t'i shtohet pjesa për fazën e cila ka qenë e larguar.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që ta **aprovtojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP07089 në vlerë prej 2,491.18 €, e datës 26.11.2008.
2. Të llogarisë vetëm 33 % të energjisë elektrike prej periudhës 12/2006 e deri 11/2008 kur edhe është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik, pra faturave të energjisë elektrike (periudha 12/2006 – 11/2008) t'i shtohet pjesa për fazën e cila ka qenë e larguar.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar